

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimeve publike në kuadër të hartimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, u konsultua specifikisht për 20 ditë pune. Data e hapjes së konsultimeve publike në Regjistrin elektronik është data 13.11.2024 dhe data e mbylljes 11.12.2024.

3. Metoda e konsultimit

1. Metoda e përdorur për konsultim ka qenë me anë të konsultimit elektronik në RENJKP.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, mund të listojmë si palë

të interesuar Agjencinë së Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian, e cila në kuadër të rekomandimeve dhe referencave të diktuar nga direktivat e BE, ka ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për kryerjen e hartimit të këtij akti.

Vlen të përmëndim se për shkak të natyrës së funksionit të AAPAA por edhe të ndryshimit ngushtësisht struktural që pretendohet të kryhet më anë të këtij akti, përvec grupit të punës të përbërë nga stafi i AAPAA, nuk ka patur palë apo grupe të tjera interesi.

Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

Në përfundim të periudhës së konsultimit publik është konstatuar se konsultimi elektronik ka marrë 242 shikime por nuk ka patur asnjë koment apo propozim nga palë të interesuara.